SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË- BEDËR

Të studiosh në Bedër

TË STUDIOSH NË BEDËR

Të studiosh në Universitetin “Hëna e Plotë”(Bedër) nuk do të thotë të marrësh vetëm një formim akademik, por njëkohësisht të përfitosh nga një eksperiencë e pasur aktivitetesh. Të studiosh në Universitetin Bedër do të thotë: të bëhesh pjesë e një mjedisi multikulturor, që përbëhet nga studentë me kombësi të ndryshme, të ndjehesh në qendër të vëmendjes së një institucioni jofitimprurës që ka në fokus studentin, të përfitosh nga mundësitë që ofron universiteti, duke e kthyer jetën studentore në një kohë dinamike që rrjedh shpejt, por që lë gjurmë në formimin e gjithsecilit që bëhet pjesë e kësaj eksperience.

PSE BEDËR ?

- Staf akademik cilësor i përbërë me pedagogë nga 8 vende;
- Ambient multikulturor me studentë nga 15 vende;
- Bursa studimi, mbështetje për ekselencën;
- Programe shkëmbimi me universitete në Europë dhe SHBA;
- Praktika studentore në kompani dhe institucione brenda dhe jashtë vendit;
- Infrastrukturë e standardeve bashkëkohore;
- Bibliotekë e pasur tradicionale dhe elektronike;
- Jetë studentore e pasur dhe dinamike;
- Programe studimi në shqip dhe anglisht;
- Universitet transparent dhe gjithëpërfshirës në aktivitetin akademik dhe kërkimor

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Departamenti i Drejtësisë

- Bachelor në Drejtësi
- Master i Shkencave në Drejtësi/ profili e Drejta Penale
- Master i Shkencave në Drejtësi/ profili e Drejta Ndërkombëtare

Departamenti i Shkencave të Komunikomit

- Bachelor në Shkenca Komunikimi
- Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi/ profili Gazetari
- Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi/ profili Marrëdhënie me Publikun

Departamenti i Shkencave Islame

- Bachelor në Shkenca Islame
- Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame
- Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame

FAKULTETI I FILOLOGJISË DHE EDUKIMIT

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze

- Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Master Shkencave në Përkthim dhe Interpretim
- Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm

Departamenti i Shkencave të Edukimit

- Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji
- Bachelor në Arsim Parashkollor dhe Fillor
- Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji
- Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor, Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke

- Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke
- Master Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke
- Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Turke për Arsimin e Mesëm

JETA STUDENTORE

Dekani i studentëve

Prania e dekanit të studentëve në strukturën e universitetit është mundësi e mirë për studentët. Kjo njësi është konceptuar të jetë tërësisht në mbështetje të studentëve, duke ndihmuar në zhvillimin e aktiviteteve të organizuara nga klubet studentore, praktikat profesionale brenda dhe jashtë vendi, planifikimin e karrierës etj.

Pjesmarrja në vendimmarrje

Studentët janë elementi bazë i ekzistencës së një universiteti. Si të tillë zëri i tyre duhet të dëgjohet në vendimmarrjen e universitetit. Këshilli studentor, i zgjedhur nga vetë studentët, ka përfaqësuesin e tij në organet kryesore drejtuese të universitetit.

Bursa studimi

Bursa studimi për më të mirët e maturës shtetërore, fituesit e olimpiadave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe per maturantët që rënditen në treshen e parë të shkollave ku studiojnë.

Klubet studentore

Studentët mund të përfshihen në aktivitetet sociale nëpërmjet anëtarësimit në grupet studentore që janë ngritur dhe funksionojnë në universitet.

BIBLIOTEKA

Biblioteka është e projektuar me qëllim që studentët të kenë mundësi për të studiuar dhe për të bërë kërkime. Biblioteka ka një fond shumë të pasur me libra dhe botime të tjera shkencore në fushat sociale, ku është përqendruar dhe aktiviteti i universitetit, siç janë drejtësia, shkencat e komunikimit, filozofia, letërsia angleze, shkencat islame, letërsia turke, psikologjia dhe shkencat e edukimit.Titujt janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit administrativ dhe akademik.

Biblioteka

ZYRA E PLANIFIKIMIT TË KARRIERËS

Kjo zyrë zhvillon aktivitete që kanë si qëllim afrimin e institucioneve të sektorit privat ose publik me studentët aktualë ose të diplomuar, të cilët përbëjnë burime njerëzore të mirëkualifikuara për tregun. Për këtë arsye është konsoliduar tashmë një rrjet biznesesh dhe institucionesh publike e private me të cilat bashkëpunohet në funksion të praktikave dhe punësimit të studentëve.

PËRFAQËSOJMË SHQIPËRINË NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

WHITE & CASE JESSUP CUP

Studentët e drejtësisë përfaqësojnë Shqipërinë në konkursin "Jessup" në Washington.

Ekipi i përbërë nga studentët Anisa Kolgjini, Ermira Skreta, Emsal Ajredini dhe Armando Sina do të përfaqësojnë Shqipërinë për herë të parë në këtë konkurs.

Studentët e Bedër, në konkursin e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë

Studentët Ermira Bushi, Izmira Kastrati, Geraldo Taraj, Ermal Mema dhe Ervisa Gjinika përbëjn ekipin garues që do të përfaqësojë vendin tonë në konkursin e stimulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë. s në këtë konkurs ndërkombëtar.

KAMPUSI I RI UNIVERSITAR

Kampusi universitar përbën investimin më të madh dhe tregon seriozitetin e kësaj sipërmarrje në fushën e arsimit universitar. Kampusi po ndërtohet mbi një sipërfaqe të hapur rreth 7000 m^2 dhe 14 000 m^2 hapësirë të mbyllur.

Ky kampus është projektuar si një hapësirë e pajisur me teknologjinë më bashkëkohore, në mënyrë që t'u ofrojë studentëve avantazhe të mëdha si në kryerjen e aktivitetit të tyre mësimor, por edhe në ndjekjen e aktiviteteve sociale. Kampusi i ri do të jetë i gatshëm për vitin akademik 2015-2016.

&Media
Communication Center

QENDRA E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT

Qendra e medias dhe komunikimit është një mundësi mjaft e mirë për studentët e shkencave të komunikimit, por edhe më gjerë, për të praktikuar dijet teorike. Qendra është menduar si një grupim i disa njësive, ku bëjnë pjesë një studio televizive, radio, portal informativ, revistë, studio dublimi dhe një televizion me transmetim vetëm në internet.

KRITERET E PRANIMIT

Pranimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor

Kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në Universitetin "Hëna e Plotë" (Bedër) duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Mesatare mbi 8 (mund ta kryejnë regjistrimin, pas shqyrtimit të dosjes nga komisioni përkatës);
- Provim pranimi për ata që nuk përmbushin kriterin e mesatares;
- Letërmotivimi (ese të shkurtër rreth motivit të zgjedhjes së programit të studimit);
- Intervistë nga komisioni i ngritur, sipas departamenteve përkatëse.

Dokumentacioni:

- Diploma origjinale e shkollës së mesme;
- Lista e notave origjinale e shkollës së mesme;
- Fotokopje e pasaportës ose e kartës së identitetit;
- Raport mjekësor;
- 4 fotografi;
- Mandati bankar i pagesës.

Për çdo informacion të detajuar, në lidhje me regjistrimet, kontaktoni në numrat e mëposhtëm:

· +355 67 34 27 001

· +355 68 64 318 83

· +355 69 67 84 014

· +355 66 57 65 629

Ju mund të aplikoni direkt për t'u regjistruar në një program studimi, duke plotësuar formularin në faqen e internetit të universitetit.

http://www.beder.edu.al/sh/content/default/online-aplication-12/6/155

KONTAKTE

Adresa: Rr. “Jordan Misja”, **Tiranë- Shqipëri**
Telefon: +355 4 24 19 200
Mobile: +355 67 23 38 333
Web: www.beder.edu.al
E-mail: admissions@beder.edu.al